

PROKURORIA E PËRGJITHSHME
Nr. 68 /22 Prot.
Dati 05/03/2021
DREJTORIA *Talidorek*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**PROKURORIA PRANE GJYKATES SE SHKALLES SE PARE
SARANDE**

Adresa : Lagja Nr.1. Rruga 'Onbezmi'-Sarande

Tel/Fax: ++3558522278

Nr. 3P5/1 Prot. L.M.

Sarandë më 28.02.2021

Lënda : Dërgim Raporti Vjetor !

*Z. Lekta
28.02.2021*

PROKURORISË SË PËRGJITHSHME
DREJTORIA E KOORDINIMIT INSTITUCIONAL/SEKTORI I KOORDINIMIT DHE STUDIMEVE


TIRANE

Bashkëlidhur shkresës po Ju dërgojmë të printuar dhe në formë elektronike (CD) raportin vjetor mbi ecurinë e punës në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë përgjatë vitit 2020, si dhe evidencat statistikore.

Duke Ju falënderuar për mirëkuptimin,

DREJTUESI I PROKURORISË

LORENC MËRKURI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA E PËRGJITHSHME
PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË
ME JURIDIKSION TË PËRGJITHSHËM
S A R A N D Ë

A N A L I Z Ë

E TREGUESVE KRYESORË TË PUNËS PËR VITIN 2020
NË PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË¹
SARANDË

DREJTUAR:

PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Z.OLSIAN ÇELA
T I R A N Ë

I nderuar z.Prokuror i Përgjithshëm!

Në zbatim të detyrimeve të përcaktuara në::

- Ligjin Nr.76/2016*, datë 22.07.2016 “PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8417, DATË 21.10.1998, KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË (të ndryshuar)”, PJESA E DHJETË, Neni 148/1/2/3 dhe Neni 148/b, gërmë “dh”
- Ligjin Nr.97/2016*, datë 06.10.2016 “PËR ORGANIZMIN DHE FUNKSIONIMIN E PROKURORISË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, Neni 50/2
- Urdhërat dhe Udhëzimet e Prokurorit të Përgjithshëm* lidhur me raportin vjetor të Drejtuesit të Prokurorisë dhe përbajtjen e tij, si dhe akte të tjera ligjore në fuqi::

Në përfundim të periudhës së ushtrimit të funksioneve ligjore përgjatë vitit paraardhës (01.01.2020 deri 31.12.2020) Ju paraqesim “Raportin Vjetor” të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë me Juridikcion të Përgjithshëm Sarandë.

Raporti përfshin arritjet dhe objektivat e realizuar gjatë ushtrimit të ndjekjes penale, në fazën e hetimit paraprak dhe në gjykim, kryerjen e detyrimeve të tjera të parashikuara në ligj nga prokurorët, oficerët e policisë gjyqësore dhe administrata e institucionit, analizën me treguesit sasiorë e cilësorë në përgjithësi, por dhe veçantitë e tyre.

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë me Juridiksion të Përgjithshëm Sarandë ushtron funksionet në bazë të kompetencave ligjore, në një territor që përfshin:

- | | |
|----------------------------|-----------------------------|
| 1- <i>Bashkinë Sarandë</i> | 3- <i>Bashkinë Finiq</i> |
| 2- <i>Bashkinë Delvinë</i> | 4- <i>Bashkinë Konispol</i> |

Territori ku ushtrojmë kompetencën tokësore përfshin një sipërfaqe dhe numër popullsie të konsiderueshëm që vjen vazhdimisht në rritje, me lëvizje të shumta të njerëzve dhe mjeteve me destinacion dhe shtete të tjera, sidomos fqinjin tonë jugor, Greqinë, pra me dinamikë të konsiderueshme. Në periudhën e verës rritja është tepër e ndjeshme për shkak se zona ofron mundësi e resurse turistike tepër të rendësishme në rang vendi.

Gjatë vitit 2020 janë trajtuar një numër i madh çështjesh, materiale kallzuese, procedime, çështje të mbartura apo të rifilluara, me problematika të gjera, por dhe të tjera në ushtrim të funksionit. Ka patur aktivitet të konsiderueshëm në përfaqësimin në gjykim, ekzekutimet e vendimeve dhe marrdhëni të juridiksionale me shtetet e huaja. Në veprimtarinë tonë do të veçnim atë që lidhet me grupin e veprave penale kundër personit (krimet kundër shëndetit, krimet seksuale, veprat penale kundër fëmijëve, martesës e familjes), grupin e veprave penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike dhe krimet kundër autoritetit të shtetit. Sipas përcaktimeve më të fundit ka nisur të funksionojë trajtimi i çështjeve me + subjekte a persona të dëmtuar të mitur.

Në këtë kuadër, duke zbatuar detyrimin kushtetues si autoriteti i vetëm për ushtrimin e ndjekjes penale, jemi përpjekur për të kryer një hetim të plotë e të gjithanshëm, mbi të gjitha procedimet e trajtuarë gjatë këtij viti, për të ngritur dhe përfaqësuar sa më mirë akuzën në gjykim, për të ekzekutuar në kohë vendimet penale të gjykatave dhe për të mbikqyrur në vazhdimësi vuajtjen e dënimit.

Nga prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore të seksionit pranë kësaj Prokurorie ka patur veprimtari me cilësi të mirë, seriozitet dhe rezultate të dukshme. Syntimet kryesore kanë qenë:

- *vlerësimi në kohë dhe me seriozitet i materialeve të para hetimore, arritura në një konkluzion të bazuar për mundësinë e rregjistrimit ose jo të procedimit penal, në funksion të zgjidhjes së pritshme përfundimtare.*
- *hetimi profesional, i gjithanshëm dhe në kohë të arsyeshme.*
- *imprenjimi mbi ngarkesën, e domosdoshme për shkak të vëllimit të lartë të punës.*
- *përfaqësimi korrekt, dinjitoz dhe efektiv në gjykatë.*
- *veprimi maksimal i shpejtë dhe efikas në procesin e ekzekutimit.*
- *raporte korrekte, të shpejta dhe të plota me zyrat përkatëse në Prokurorinë e Përgjithshme, K.L.P, KLGJ, Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Brendshme dhe institucionet apo autoritetet e tjera.*
- *komunikime ligjore dhe etike korrekte me palët, subjektet, institucionet, autoritetet apo të interesuarit.*

Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë janë përcjellë e njoftuar Udhëzimet e Prokurorit të Përgjithshëm, Rezoluta e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, Rekomandimet Prioritare të Këshillit të Ministrave dhe aktet në zbatim të tyre, komunikimet me Avokatin e Popullit, institucionet tjetra të vendit dhe të huaja etj. Të gjitha këto, por dhe komunikime, urdhërime, bashkëpunime etj. të çdo lloj niveli trajtohen e ndiqen për zbatim rregullisht në punën tonë, mbledhjet dhe diskutimet, duke evidentuar në veçanti momentet që lidhen direkt me veprimtarinë tonë. Ato kanë patur ndikimin dhe efikasitetin e tyre, duke sjellë praktika e zotime të reja, ndërkoq që ka dhe veprime konkrete strukturale, për sa eshtë // e mundur për shkak të organikës së kufizuar. Rol i Prokurorit të Përgjithshëm në nxjerrjen e udhëzimeve të përgjithshme për prokurorët e prokurorive të juridiksonit të përgjithshëm, për oficerët e policisë gjyqësore eshtë tepër i rëndësishëm, ndaj mbikqyrja e zbatimit të tyre ka qenë objektiv i punës tonë. Nga ana jonë janë përcjellë rregullisht dhe në vazhdimësi statistika, të dhëna me interes, shpesh të njehsuara që pasqyrojnë dhe analizojnë kriminalitetin, prirjet e tij, politikën penale të zbatuar dhe efektivitetin e saj, efektivitetin e instituteve penale të parashikuara në kuadër dhe të ndryshimeve në drejtësinë penale.

Nga Drejtuesi eshtë proceduar me urdhërime të nevojshme në zbatim të ligjit dhe udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm, kur ka qenë e nevojshme në zbatim të ligjit dhe procedures. Ato kanë patur ndikimin dhe efikasitetin e tyre, duke sjellë dhe praktika e zotime të reja.

Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë ka patur angazhim dhe bashkëpunim maksimal me Prokurorinë e Përgjithshme dhe institucionet përkatëse me qëllim përshtypjetimin e procesit të rivlerësimit profesional të prokurorëve në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar të prokurorëve. Informacionet janë dërguar rregullisht, në kohën më të shpejtë të mundur dhe me korrektesë. Është një korrespondencë që përfshin komunikime pothuaj të përditshme. Institucioni ka ndjekur me vëmendje çështjet që lidhen me verifikimin e integrititetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike, ndërsa disponon irregullore të posaçme për respektimin e standardeve etike dhe profesionale në funksion të forcimit të integritetit të prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore.

Në vitin 2020 janë ushtruar funksionet ligjore dhe ato që burojnë nga urdhërat e udhëzimet. Konstatohet ecuri pozitive, pavarësisht problematikave, ka një komunikim e bashkëpunim serioz institucional e ndërinstitucional, me rezultate pozitive konkrete, ka vlerësim e mobilizim nga strukturat, ndërsa mbeten ende një sërë problemesh, zgjidhja e të cilave do të përmirësonte më tej punën ku veçojmë: *mangësitë numerike*, profesionale dhe në përvojë konkrete, si dhe *plotësimi i kuadrit ligjor* që lidhet me veprimtarinë e policisë gjyqësore dhe shërbimeve; *lëvizjet e shumta dhe të shpeshta* në organikën e shërbimeve të policisë gjyqësore; *problemët e infrastrukturës* dhe ato që lidhen direkt me to. Në zbatim të frymës së re kushtetuese dhe detyrimeve të reja ligjore, po merren masat për krijimin e një

raporti të drejtë të mënyrës së funksionimit, në përshtatje me të, pavarësisht mangësive dhe faktit që ka ende nevojë për plotësimin e kuadrit dhe praktikës ligjore.

Në vazhdimësi është përmirësuar bashkëpunimi me institucionë të tjera ligjzbatuese, në kushtet kur territori ku ushtrojmë funksionet ndodhet në kufirin midis shteteve dhe ka ndikim në raportet tona me fqinjët, komunitetin ndërkombëtar dhe për më tepër në kuadrin e procesit të integrimit. Parandalimi dhe goditja më e mirë e veprimtarisë së paligjshme krijon premisa pozitive me ndikim evident e të drejtpërdrejtë në këtë fushë. Ka ecuri të mirë në këtë aspekt, përfshi dhe reagimin e institucioneve, ndërsa mbetet problem situata me shërbimet shtetërore ku evidentohen mangësi të veprimit administrativ, por dhe *kallzimet formale pa vlerë* të shtetasve e institucioneve, shpesh për motive që nuk afrojnë me ndjekjen penale dhe që krijojnë një ngarkesë formale.

Rezoluta e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë dhe Rekomandimet e Këshillit të Ministrave për luftën kundër kriminalitetit kanë qenë në objektin e punës tonë.

Garantimi i pavarësisë dhe përgjegjshmërisë së prokurorit

Në punën tonë kemi patur parasysh se organi i ndjekjes penale duhet të jetë i pavarur dhe i paanshëm, jo vetëm si një kërkesë bazë për ekzistencën e procesit penal, por dhe përcaktuese për gjithë sistemin e drejtësisë penale, ndaj kemi synuar zbatimin rigoroz të legjislacionit me profesionalizëm dhe objektivitet që ndikon vendosmërisht në luftën kundër kriminalitetit dhe vëndosmërisht në luftën kundër kriminalitetit dhe vënies përpara përgjegjësisë së autorëve të veprave penale.

Me krijimin e Prokurorisë së Posaçme (SPAK) kemi synuar e realizuar raportin ndërinstitucional, lidhur me identifikimin e kompetencës materiale, kalimin e kompetencës midis prokurorive, me synimin e garantimit të efektivitetit të hetimit dhe vënies përpara përgjegjësisë së autorëve të tyre. Kemi garantuar praktikisht pavarësinë e prokurorit gjatë ushtrimit të detyrës, ndërsa janë përcaktuar, orientuar, diskutuar e vënë në zbatim mekanizmat ligjorë për: respektimin e standardeve etike dhe profesionale, në funksion të forcimit të integritetit, eficencës dhe përgjegjshmërisë; forcimin e rolit aktiv të prokurorit në hetimin paraprak, ndërsa mbetet e vakët situata lidhur me hetimet e filluara kryesish; rritjen e rolit të prokurorit në drejtimin e policisë gjyqësore me qëllim rritjen e efektivitetit dhe llogaridhënisë së strukturave të policisë gjyqësore; për garantimin e paanshmërisë dhe shambahien e cdo lloj influence ose ndikimi ndaj prokurorit ashtu si dhe forcimin e mekanizmave të kontrollit dhe llogaridhënisë së prokurorëve, ndërsa mbetet e nevojshme ngritura e mëtejshme e kapaciteteve dhe trajnimeve për specializimin e prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore

Luftha kundër korruptionit.

Luftha kundër korruptionit mbetet një nga sfidat kryesore për garantimin e pavarësisë së institucioneve dhe organeve publike, zhvillimin ekonomik dhe zhvillimin shoqëror të Shqipërisë. Finalizimi i integrimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian mund të arrihet vetëm duke vendosur një standart të lartë në luftën kundër korruptionit. Në këtë drejtim, duke patur parasysh dhe përcaktimet ligjore për pozicionin dhe kompetencat e këtij institucioni kemi bërë përpjekjet tona në aspektet që mund të procedojmë. Mbetur shumë punë për të bërë

ende lidhur me shtimin e numrit të hetimeve proaktive dhe numrit të rasteve të përdorimit të metodave speciale të hetimit për këto vepra penale. Në proces janë hëtime me interes për evidentimin dhe veprimin ndaj aseteve kriminale, ndërsa bashkëpunimi funksionon me të gjithë institucionet e nevojshme, në veçanti me Prokurorinë e Posacmë dhe ka nisur puna për evidentimin sa më të mirë statistikor të të dhënave për veprat penale përkatëse.

Luftha kundër krimtit të organizuar.

Pavarësisht se ky organ ka aktivitet ligjor që përcaktohet i kufizuar në drejtim të trajtimit të rasteve që mund të lidhen me krimin e organizuar nuk ka munguar asnjëherë bashkëpunimi me SPAK dhe struktura të tjera, ndërsa jemi fokusuar në drejtim të pastrimit të parave nga krimi. Megjithë vështirësive reale për shkak të informalitetit, informacionit të kufizuar dhe kamuflimit apo mungesës së dukjes së aseteve, po bëjmë përpjekje për të qenë në hapin e duhur me hetimet në këtë drejtim.

Nga ana jonë, duke qenë se nuk përfshihemi në prokuroritë që krijojnë një strukturë (seksion) të posaçmë për shkak të organikës së kufizuar, referuar udhëzimit përkatës eshtë përcaktuar “prokurori i posaçëm”, konkretisht z.Ilir Hoxha që ndjek grupveprat penale kundër pastrimit të parave, financimit të terrorizmit, krimeve financiare dhe hetimeve pasurore, si dhe oficeri i policisë gjyqësore z.Altin Avduli. Gjatë kësaj kohe kemi përcjellë informacionet e nevojshme në këtë drejtim, kontaktet dhe komunikimet kanë qenë të vazhdueshme. Jemi në përpjekje të standartizimit dhe perfektionimit të mëtejshëm të këtij procesi, duke përfshirë dhe mundësitë e trajnimit për prokurorin dhe oficerin e policisë gjyqësore. Në drejtim të grupveprave penale evidentohen një numër procedimesh konkrete, destinuar prej këtij momenti tërësisht në strukturën e re të ngritur. Në funksion të kësaj veprimtarie kemi krijuar e paraqitur të dhëna statistikore të nevojshme dhe me interes (janë 12 procedime të kësaj natyre). Në aspektin e luftës ndaj narkotikëve kemi reaguar me të gjithë mundësitë dhe mjetet në dispozicion, duke patur një situatë në kontroll të territorit dhe në përmirësim të vazhdueshëm. Niveli i çështjeve dhe subjekteve të trajtuar nga ana jonë nuk ka evidentuar vlera të tilla të rangut të përafrueshëm apo krahasueshëm me financues apo drejtues të grupeve dhe rrjeteve kriminale në kuptim të ligjit dhe praktikës.

Respektimi i të drejtave të njeriut.

Respektimi i të drejtave të njeriut është padashim një prioritet i punës tone. Janë aplikuar dukshëm dënimet alternative për autorë me rrezikshmëri të ulët shoqërore; ka seriozitet maksimal për zbatimin e kodit penal për të miturit me qëllim trajtimin e të miturit në kontakt me organet e drejtësisë në zbatim të legjislacionit; ka reagim dhe veprim pozitiv konkret në masat e sigurimit dhe dënimin për veprat ndaj familjes, ato me natyrë gjinore dhe diskriminuese, për rastet e keqtrajtimit/abuzimit etj. të fëmijëve dhe të miturve.

Mbi bashkëpunimi ndërinstitucional.

Bashkëpunimi ndërinstitucional ka qenë brenda të gjithë parametrave të mundshëm e të realizueshëm, përfshi ILDKPKI-në, KLSH-në, DPPP-në, ASHK-në edhe mjaft subjekte të tjera si: bankat, agjencitë e pasurive të paluajtshme, organet tatimore, organet e pushtetit lokal. Bashkëpunimi ndërkombëtar ka qenë i vazhdueshëm në funksion sidomos të hetimit,

procedurave të ekstradimit dhe njohjet e vendimeve të huaja, etj. Rritja e tij është e ndjeshme vit pas viti duke krijuar padyshim një bazë të mirë dhe përmundësinë e ngrijtes së grupeve të përbashkëta në të ardhmen.

Nisur nga veprimtaria institucionale në drejtim të zotimeve në kuadër dhe të rekomandimeve të Kuvendit, Këshillit të Ministrave, Avokatit të Popullit etj. evidentohet:

- + ka ecuri të mirë në hetimet proaktive, sidomos për veprat penale të prodhimit dhe shitjes së narkotikëve, trafikimi të narkotikëve dhe kultivimit të bimëve narkotike
- + ka hetime pasurore për identifikimin, sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive, mjeteve dhe produkteve të veprave penale me origjinë kriminale, sipas legjislacionit të fuqi për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korruzionit
- + janë respektuar rregullat për ruajtjen e sekretit hetimor për procedimet dhe nuk është cënuar besimi i publikut në hetimet penale
- + statistikat për procedimet penale në përgjithësi, për sa ka qenë e mundur janë standartizuar
- + ka vijuar mjaft mirë puna në mbështetje të procesit të rivlerësimit kalimtar të prokurorëve sipas detyrave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi
- + bashkëpunimi ndërinstitucional në nivel qëndror dhe vendor është rritur dhe përmirësohet
- + bashkëpunimi me autoritetet gjyqësore të huaja është shumë i mirë
- + ka ecuri të mirë në trajtimin e të miturve me kontakt në drejtësinë penale dhe ecurinë e zbatimit të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur
- + janë marrë masat për mbrojtjen e të drejtave të viktimateve të veprës penale dhe për të adresuar dhe rekomanduar zgjidhje për zbatimin e drejtë të rregullave për kërkesat e viktimës akuzuese
- + ka rritje e përdorim më efektiv të instituteve procedurale si: urdhri penal, marrëveshja e fajësisë, gjykimi i drejtpërdrejtë, etj.
- + janë marrë maksimalisht masat për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, mbrojtjen e interesave të ligjshëm ekonomikë, parandalimin e torturës, respektimin e të drejtave të personave të privuar nga liria, në komisariatet e policisë, vendet e ekzekutimit të vendimeve penale, pikat e ndalimit kufitar etj.
- + janë marrë gjithashtu masat e nevojshme për menaxhimin e ankesave dhe kërkesave për informacion, rritjen e cilësisë dhe shpejtësisë së hetimit, barazinë përpara ligjit dhe mosdiskrimimin.
- + materialet kallëzuese të trajtuara nga prokuroria dhe procedimet penale të regjistruara nuk kanë shënuar rritje, ndikuar nga kushtet e pandemisë prej COVID-19; procedimet penale për vjedhjet mbeten përsëri në pjesë dérrmuese, pasuar nga veprat penale kundër rendit dhe sigurisë publike; të pandehurit janë në shumicë meshkuj, kryesisht me arsim të ulët ose të papunë; të punësuarit janë shumica në sektorin privat dhe banojnë kryesisht në zonat urbane.

Në pjesën më tej në këtë analizë, në kuadrin e pasqyrimeve më konkretë në raport me të dhënat statistikore, shfaqet më qartë veprimitaria në këto drejtime.

-II-

Në përputhje me urdhërat dhe udhëzimet e Prokurorit të Përgjithshëm, në veprimitarinë e gjithanshme ka realizime dhe përpjekje të dukshme e konkrete, ku përmendim:

Rritja e pavarësisë së prokurorëve dhe forcimi i kuptimit më të mirë të përgjegjësive nga çdo prokuror është evidente, po ashtu koordinimi i punës ndërmjet prokurorive të ndryshme, mes tyre dhe policisë gjyqësore të përfshira në hetimet. Respektimi i ligjit për sekretin hetimor nga çdo prokuror dhe punonjës i prokurorisë është i dukshëm, komunikimet me publikun dhe median janë korrekte. Shpejtësia e hetimit ndikohet shumë nga ngarkesa dhe komunikimi i shtuar procedural, ndërsa bashkëpunimi me agjencitë ligjzbatuese mbetet aktiv, përfshi ato ligjzbatuese ndërkomëtare. Ka përmirësim të cilësisë së hetimeve të kryera me qëllim rritjen jo vetëm të personave të dërguar për gjykim, por edhe rritje të personave të dënuar me vendim të formës së prerë (sidomos llojet e reja të gjykimit).

Prokurorët janë pjesë e programeve të trajnimit dhe seminareve rregullisht, përfshi ato për specializimin në funksion të njohjes dhe zbatimit të legjislacionit penal në fusha të veçanta, pjesëmarrrja ka qenë e rregullt në këtë aspekt. Prokurorët kanë ezauruar programin e detyrueshëm të trajnimit pavarësisht se është proceduar online për shkak të situtës së pandemisë. *Orientimet janë të përhershme* dhe në çdo rast për forcimin e rolit aktiv të prokurorit në hetimin paraprak, në funksion të shtimit të rasteve të hetimeve të filluara kryesisht nga vetë organi i prokurorisë. Ngarkesa e punës e kufizon mundësinë praktikisht për shtimin e tyre ndërsa ka më tepër aktivitet në bashkëpunimin me policinë për hetime proaktive.

Zbatimi i kuadrit të ri ligjor lidhur me drejtësinë për të mitur është realizuar me korrektesë, duke garantuar procesin e rregullt ligjor në çdo fazë të ndjekjes penale, gjykimit dhe ekzekutimit. Ka një Seksion të Posaçëm për të Miturit, përbërë nga prokurorët: Shef Seksioni z.Elidon Hysenaj, prokurorë zj.Alba Dhima dhe Aurora Hajro, si dhe oficeri i policisë gjyqësore z.Napolon Hodaj. Ky organizim mbulon tërësisht dhe në vazhdimësi procedimet sipas ligjit me subjekte apo të dëmtuar persona të mitur. Hetimet janë të shpejta dhe pse të shumta, por pavarësisht ngarkesës respektimi i të drejtave dhe garancive proceduriale ka qenë evident. Ka përparësi për masat alternative të shmangies dhe kufizimi apo heqja e lirisë është trajtuar padyshim si masë e fundit. Ka nevoja të mëtejshme për trajnimin e oficerëve të policisë gjyqësore dhe personave të tjera të specializuar në drejtësinë për të mitur.

Mbetet problematike situata me veprat penale të dhunës në familje, ndërsa nga ana jonë zgjatja në kohë e hetimeve në këto raste mbetet tejet e arsyeshme. Zbatimi i kuadrit të ri ligjor në funksion të garantimit të procesit të rregullt ligjor për viktimat e veprës penale në

përgjithësi dhe në veçanti për viktimat e dhunës në familje është gjithashtu evident dhe kjo duket dhe nga suksesi në pjesën dërrmuese të rasteve në gjykim.

Forcimi i bashkëpunimit midis policisë dhe prokurorisë si dhe me institucionet e tjera ligjzbatuese brenda dhe jashtë vendit është evident, madje dhe me rezultate konkrete. Komunikimet ligjore, proceduriale e administrative me policinë janë ezauruar për aq sa parashikon ligji, me korrektesë. Procesi i delegimet të dosjeve ecën rregullisht, por nuk shtrihet gjerë në shërbimet e policisë gjyqësore në institacione të tjera, për shkak të mangësive në aspektin lokal. Bashkëpunimi ndërinstitucional me të gjithë faktorët ka qenë impenjues për t'u përgjigjur drejt për shkëmbimin në kohë reale të informacionit, përmirësimin e cilësisë së akteve, shpejtësisë së kryerjes së veprimeve proceduriale, përfshi dhe ato në kuadër të ekzekutimit të ekstradimeve dhe letërporosive duke qenë maksimal.

Ka tendencë pozitive në bashkëpunim institucional për hetimet proaktive dhe teknikat speciale të hetimit, me raste konkrete, por dhe për kryerjen e hetimeve pasurore. Mbetet ende punë për të bërë përritjen e numrit të aseteve të sekuestruara që prej fazës fillestare të hetimit dhe konfiskimin e tyre në përfundim.

Në veprimitarинë hetimore është ngritur në një nivel më të lartë respektimi i të drejtave të njeriut, trajtimi i rasteve me të mitur dhe grupet vulnerabël në aspekte konkrete. Prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore janë prezent në rastet e kufizimeve të lirisë në momentet e para, në veçanti dhe me impenjim maksimal në rastet e fakteve komplekse apo që lidhen me vepra të rënda penale. Kjo ka dhënë dhe rezultatet konkrete si në zbardhjen e ngjarjeve dhe në vlerësimet faktike nga gjykata në procese. Në të njëtin mënyrë impenjimi ka qenë maksimal për çështjet me të mitur, në të gjithë procedimet vlerësimi i rasteve nga prokurorët ka qenë maksimal, ndërsa nuk ka raste të dështimeve në çështjet për shkak të shkeljeve që lidhen me të drejtat e njeriut (respektohet procesi i drejtë, pjesëmarrja e mbrojtjes apo të pranishmëve të tjerë që detyron ligji, etj.). Tashmë kjo veprimitari po ecën në vazhdimësi. Rastet e të dëmtuarit në procesin penal trajtohen me seriozitet; komunikimi zyrtar dhe me personat ka qenë korrekt dhe në përmirësim të vazhdueshëm. Në raport me vitin e mëparshëm, duke patur një kujdes më të madh janë bërë pëpjekje për vlerësimin dhe trajtimin e rasteve në një kohë sa më të shkurtër dhe uljen e kohës së paraburgimit.

Mbetet i lartë numri i vendimeve të mosfillimit që sjell ngarkesë më të madhe, sidomos për prokurorët, për shkak të ngushtimit të hapësirave kohore për daljen me vendim përfundimtar, po ashtu dhe për seancat kur ankimohen (shpesh dhe për shkaqe banale), por ndikon në përmirësimin e imazhit dhe vlerësimëve pozitivisht në kohë pa ndikuar në cilësinë, ndërsa është përmirësuar ndjeshëm procedura e njoftimit. Problem specifik ketu vazhdon të mbetet zhvendosja e shpeshtë drejt spitaleve në Tiranë të personave të dëmtuar në veprat apo faktet e dyshuara si penale.

Kallzimet e paraqitura nga institucionet janë trajtuar me kujdes, në kuadrin e procedimeve penale dhe karakteristike e tyre është se kërkojnë impenjim, veprime hetimore të shumta dhe shpesh kostojë e lartë e ekspertimeve.

Nevoja e udhëzimeve mbetet e vazhdueshme, për më tepër në kushtet e ndryshimeve të shumta ligjore dhe mungesës së praktikave të konsoliduara, sidomos kur ato trajtojnë probleme që krijojnë pengesa në ushtrimin e funksionit (raste që kërkojnë zgjidhje), lidhen me ushtrimin e ndjekjes penale si detyrë bazë e prokurorit, janë sa më të thjeshta (pa përshkime të zgjatura ligjore dhe ngarkesa burokratike që mund të jenë të papërballueshme), duke kriuar dhe një uniformitet institucional në rang kombëtar.

Në vitin 2020 ngarkesa në shifra është e konsiderueshme, nuk ka rritje për shkak dhe të aktivitetit të kufizuar në kushtet e pandemisë, por ngarkesa e punës praktikisht mbetet dukshëm e madhe, nisur dhe nga reagimi masiv, shpesh dhe për raste jo të natyrës penale, ndërsa efektiviteti ka tendencia pozitive. Ka një numër të madh dosjesh me autor që eshtë evidente, ndërsa numri i madh i vendimeve të mosfillimeve detyron vlerësimin në një kohë më të shkurtër për shkak të afatit të kufizuar.

Në drejtimin pozitiv mund të përmendim:

- Shpejtësia në hetime ecën në nivele të pranueshme në raport me ngarkesën, ka ecuri të mirë të dukshme në procedimin me sukses me gjykime e të gjitha llojeve.
- Në masat e sigurimit, sipas nevojave janë aplikuar masa alternative si garancia pasurore, detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore, mbikëqyrja.
- Është përmirësuar ndjeshëm komunikimi dhe njoftimi për personat dhe institucionet
- Ka nivele normale koha e paraburgimit, raportet midis kërkesave tona dhe vendimeve të gjykatës shfaqen në nivele të mira, mbetet në nivele të pranueshme nevoja e apelimeve, ndërsa ka qenë pothuaj i panevojshëm aplikimi i apelit kundërshtues
- Procedimi me ekzekutimet është në nivele shumë të mira

Rastet kur janë konstatuar *mangësi në këtë aspekt* lidhen me ngarkesën e punës, zgjerimin e komunikimeve mes institacioneve dhe kërkesat e shumta për informacion të paraqitura nga palë, persona, shoqata, institacione, në kuadrin dhe të ndryshimeve ligjore të viteve të fundit.

Pavarësisht interesit pozitiv në shumë raste këto pengojnë ushtrimin e funksionit në një kohë sa më të arsyeshme, kur duhet pranuar se vazhdon një klimë jo tërësisht pozitive, por që nuk ka arritur të ndikojë në veprimtarinë ligjore funksionale. Përpjekjet tona kanë qenë maksimale për korrektesë në komunikimet publike e ato të lidhura me procedimet konkrete, por shpresojmë që me plotësimin e mëtejshëm dhe kalimin e kësaj situate tranzitore reformuese të arrihet të krijohet një kuadër ligjor që do ta fokusonte prokurorin veçanërisht në kryerjen e detyrave funksionale dhe krijimin e një imazhi më të qartë të publikut për atë ç'ka bën dhe duhet të bëjë ky institucion.

-III-

Nga problematikat e evidentuara mund të përmendim:

Disponojmë një efektiv të reduktuar në numër e funksione në raport me parashikimet ligjore, konkretisht mungon kancelari, nevojitet një administratë më e plotë, ndërsa kemi

ezauruar tashmë caktimin e zv.drejtuesit. Në këto rrethana një varg zotimesh detyrimisht shpërndahen tek të njëjtët persona, madje drejtuesi dhe kryesekretarja kryejnë disa funksione, ndërsa drejtuesi detyrohet të impenjohet dhe në çështjet penale. Nga ana tjeter çështjet, problemet e administrimit dhe të dokumentacionit, por sidomos kërkesat për informacion po rriten në mënyrë gati të papërballueshme. Kjo ndikon detyrimisht dhe në mundësinë e ndërhyrjes se drejtuesit në masë në kontrollin e çështjeve dhe problematikave konkrete.

Drejtuesi vihet kryesisht në lëvizje nga ankesat, dijeni publike, akte që paraqiten nga palët apo stafi dhe ka ndërhyrë për sa është e mundur, duke proceduar dhe me zëvendësimet përkatëse kur ka qenë e nevojshme, momenti kur hetimet janë drejt përfundimit është më së shumti mundësia me konkrete për drejtuesin, ndërsa në gjykim mundësia është minimale për shkak se jo vetëm pavarësia (për më tepër në seancë), por dhe vendimi gjyqësor aty për aty nuk lenë më vend për ndërhyrjen e drejtuesit.

Dispozitat që përcaktojnë pavarësinë e prokurorëve evitojnë dukshëm efektet e ndërhyrjes së drejtuesit, ndërsa politika penale mbetet e vështirë për tu mbajtur në metrin e duhur në nivel prokurorie. Pavarësishet efekteve pozitive që japid ndërhyrjet e drejtuesit në shumë raste, në momentin kur qëndrimi i prokurorit të çështjes shkon në një linjë me qëndrimin e gjykatës ndërhyrja e drejtuesit mbetet praktikisht e pamundur. Situata e re e pavarësisë së prokurorëve ka ende nevojë të konsolidohet në shërbim të këtij synimi, ndërsa niveli i stabilitetit të politikës penale ka probleme për shkak tashmë dhe të orientimit subjektiv. Ndërhyrja e drejtuesit mbetet ende e kufizuar për shkaqe terorike dhe praktike reale, por dhe për faktin se nuk mund të garantonhet qëndrimi në mbështetje nga gjykata që vlerëson mbi bindjen e saj.

Politika penale, si dhe më lart kemi përmendur lë për të dëshiruar në aspektin e ashpërsimit dhe jo pak ka ndikuar pavarësia e prokurorit, pasi është i mangët dhe praktikisht problematik vështrimi krahasimor nga gjykata apo vet prokurorët. Pavarësishet orientimeve të vazhdueshme të drejtuesit mbajtja e një niveli të përgjithshëm më të mirë mbetet e cënuar. Kjo situatë përfshin dhe qëndrimin në masat e sigurimit, ndërsa është dukshëm evidente rritja e dënimive alternative. Trajnimet e përbashkëta nuk mungojnë, por ka emergjencë për trajnimet specifike të oficerëve të policisë gjyqësore, të cilët janë një hallkë shumë e rendësishme e hetimeve.

Në këtë institucion tashmë janë duke u ndjekur rregulisht çështjet me të miturit, duke sjellë një tjeter rritje të ngarkesës së punës, pa përmendur impenjimin procedural të gjerë që ato kërkojnë, ndërsa mbeten të nevojshme praktikimet apo trajnimet për rastet në fjalë, sidomos për oficerët e policisë gjyqësore.

Ngarkesa e madhe dhe stafi i vogël ndikon dukshëm dhe në cilësinë e informacionit që mund të disponohet nga prokurorët për rastet kur ato janë detyrimisht të nevojshme dhe që duhet t'i përcjellim, ndikon në afrimin e tyre me sistemin, depozitimin e informacionit dhe dokumentacionit në regjistrat etj. Rritja e numrit të çështjeve penale, procedurat e reja, kërkesat pa fund për informacion po krijojnë një situatë të ngarkuar tej çdo norme dhe kjo padashim ka ndikim në ritmin dhe ecurinë e punës.

Sistemi i menaxhimit të çështjeve vazhdon të manifestojë probleme, ka pak aktivitet tē prokurorëve pér shkak tē ngarkesës, ndërsa administrata është e pamjaftueshme dhe pér çështjet penale dhe detyrat e tjera parësore. Ka padyshim nevojë pér ndërhyrje pér shkak tē cilësisë dhe ndryshimeve të reja proceduriale, po ashtu dhe pér një bazë më të mirë materiale. Shorti elektronik funksionoi rregullisht gjatë vitit dhe është proceduar rregullisht me shortin manual apo ndarjen e rasteve në bazë tē urdhërimeve ligjore të prezantuara që më parë nga drejtuesi pér tē evituar çdo problem. Në shortin elektronik duhet përmirësuar situata teknike, pasi nuk garantohet në masën e duhur shpërndarja e çështjeve në nivele maksimale tē barabarta dhe mbetet e vështirë më tej që tē realizohet dhe kompensimi me shortin manual. Në shërbim tē këtij ekuilibri kemi vendosur shpërndarjen e dosjeve tē ardhura pér kompetencë (që nuk mund tē rihidhen në short elektronik) apo praktika tē tjera (ekstradim, letërporosi) që sidoqoftë pjesërisht janë ndikuese në tentimin e barazisë së ngarkesës.

Ka mangësi tē dukshme teknike në ritjen e aksesit dhe përdorimit tē tē dhënavët në databazat shtetërore. Rritja e cilësisë së mbajtjes dhe raportimit tē tē dhënavë statistikore është e dukshme, impenjimi është maksimal, por problemet teknike me sistemin, administrata e kufizuar në numër, ngarkesa në punë dhe mosimplementimi tërësor i ndryshimeve të reja ndikojnë jo pak në këtë aspekt. Në kuadrin e profesionalizmit tē burimeve njerëzore dhe zhvillimit tē sistemit elektronik tē teknologjisë së informacionit është e nevojshme rritja e numrit dhe cilësisë së pajisjeve, sidomos ato kryesore pér ushtrimin e funksionit, por dhe e mundësive paguese pér nevojat e përhershme apo specifike tē punës.

Të dhënat statistikore që kërkohen krijojnë shpesh një ngarkesë tej çdo norme, sidomos pér faktin se nuk rakordojnë me statistikat bazë nga ndryshimet e reja dhe mangësite administrative e shtojnë problemin. Po tē shtojmë këtu dhe komunikimet me institucionet është gati e pamundur tē procedohet më shpejtësi.

Kallzimet nga institucionet në masë tē gjerë nisen nga situata që përbëjnë shkelje administrative apo thjesht pér tē shoqëruar përgjegjësinë administrative. Njoftimet dhe procedurat shtesë pengojnë ritmin e punës dhe rrisin kostot. Problemet juridike krijojnë pengesa në vlerësimet dhe ndikojnë në kohën e punës dhe zgjidhjen e problemeve, shërbimet e policisë gjyqësore kanë përherë problemet e lëvizjeve, ndërsa mbeten problem në vazhdimësi vjedhjet dhe dokumentimet pa vlera juridike penale

-IV-

Nga tē dhënat krahasuese tē përgjithshme mes dy viteve tē fundit evidentohet:

VITI 2019


<u>Procedime</u>	<u>Mbartur</u>	<u>Gjykim</u>	<u>Pezullim</u>	<u>Pushime</u>	<u>Mosfillime</u>
1065	651	313	324	89	560

VITI 2020

<u>Procedime</u>	<u>Mbartur</u>	<u>Gjykim</u>	<u>Pezullim</u>	<u>Pushime</u>	<u>Mosfillime</u>
808	847	239	404	66	583

62.


TREGUESIT VJETORË TË KRAHASUAR 2019-2020



Në një këndvështrim të përgjithshëm rezulton se veprat penale nga më të përhapurat kanë të njëjtën tendencë gjatë këtij viti:

- + veprat penale më të përhapura janë në nivele të përafërtë me një vit më parë, nuk ka rritje të numrit të çështjeve, në raportet në lidhje me efektivin janë normale, por mbartjet dhe mangësitë e mëparshme në efektiv padashim kanë ndikuar
- + mbeten problem vjedhjet (pa autor sidomos), drejtimi i mjeteve në mënyrë të parregullt, kalimi i paligjshëm i kufirit
- + veprat që lidhen me narkotikët në vështrim të quartë nuk janë më aq të përhapura (sidomos kultivimi) si në territorë të tjera të vendit; mbeten problem evidentimi i autorëve ku ndikon dhe mënyra e administrimit të tokës dhe mangësitë pronësore; ka rënje niveli i prodhimit, posedit etj. të narkotikëve, ndoshta dhe mbyllja e kufirit për shkak të pandemisë ka ndikuar, pasi përdoret dhe kontigjenti i kalimit të paligjshëm të kufirit
- + mbeten në ato nivele të veprave dhe autorëve rastet e dhunës në familje, rastet e abuzimeve në drejtimin e mjeteve, si dhe janë në nivele normale aksidentet me pasoja serioze; ka tendencë më të ulët të kalimit të paligjshëm të kufirit shtetëror, situatë që lidhet me shumë faktorë, si përkohet toni, kushtet e pandemisë, etj.
- + ngarkesa krijon probleme për hetimet proaktive dhe ato kryesish; procedura e re krijon impenjime më të mëdha në aspektin e impenjimeve dhe të drejtave të palëve që ndikojnë në cilësinë dhe sasinë e punës në vlerësimin efektiv


TENDENCAT PËR DISA VEPRA PENALE 2019-2020




Më poshtë paraqitet *përhapja e veprave penale në territor*, të trajtuar gjatë vitit 2020, ku përfshihen çështjet e mosfilluara dhe ato të rregjistrues, sipas grupimeve në Kodin Penal, duke veçuar ato me tregues përcaktues:

- *Kreu II* Vepra penale kundër personit, krime kundër jetës
- *Kreu III* Vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike
- *Kreu IV* Vepra penale kundër mjedisit
- *Kreu VIII* Krime kundër autoritetit të shtetit
- *Kreu IX* Vepra penale kundër drejtësisë

VITI 2019



VITI 2020




-V-

Nga hetimet dhe vlerësimet konkrete, në territorin që mbulon kjo Prokurori rezulton:

- është ndjerë në nivele më të ulëta dukuria për veprat penale në fushën e narkotikëve, sidomos tashmë posedimi etj., ndërkohë që mbetet problematike situata me vjedhjet dhe evidentimi i kultivuesve; shkaqet janë të ndryshme, sociale dhe ekonomike, probleme të infrastrukturës dhe edukimit të pamjaftueshëm në respektimin e rregullave e ligjeve, mosfunkcionimi i rregullt i strukturave të ndryshme shtetërore që mbikqyrin veprimtari të palejuara dhe në shkelje të ligjit, kushtet e pandemisë, etj.

- ka tendencë në rritje, madje është shqetësuese dhe krijon ngarkesë fiktive fakti se kallzohet për raste që nuk lidhen me veprimtarinë e organeve të ndjekjes penale, pasqyruar kjo dhe në vendimet e shumta të mosfillimit
- veprat penale dhe personat e hetuar e gjykuar kanë një shpërndarje të drejtë në raport me shpërndarjen e popullsisë, sipas numrit dhe territorit; numri i të hetuarve meshkuj është dominant ashtu si dhe i personave të papunë, diferenca është më e vogël tek personat e dëmtuar
- nuk ka rritje numri i të pandehurve dhe të gjykuarve; arrestimet në flagancë janë në një masë më të madhe, ndalimet nga policia gjyqesore po shkojnë drejt rënies, në mënyrë të ndjeshme ka udhëra ndalimi e kërkesa të prokurorit
- masat e sigurimit janë pranuar në shumicë nga gjykata që ka ulur ndjeshëm apelimet
- aplikimet e procedurave të reja kanë tregues pozitivë, si kërkesat në gjykatë, urdhërat penale, marrëveshjet, etj.; ka dhe një praktikë pozitive në masat e sigurimit

TENDENCA E KALLZIMEVE DHE REFERIMEVE



-VI-

Në lidhje me *strukturën e legjislacionit penal dhe subjektet* vërejmë:


- + rapportet midis krimeve dhe kundërvajtjeve penale dominohen nga krimet
- + rapportet për vendbanimin e subjekteve, qytet-fshat, tregojnë dominimin të implikimit të banorëve të zonave urbane (nuk pasqyrohet drejt nga aktet e gjendjes civile, për shkak të levizjeve demografike dhe mosrealizimit të rregjistimeve në gjendjen civile)
- + në lidhje me gjininë e subjekteve është qartësisht evidente epërsia e subjekteve meshkuj; midis subjekteve kemi patur dhe shtetas të huaj; niveli i ulët arsimor në masë i subjekteve është gjithashtu evident
- + niveli më i lartë i veprave penale dhe autorëve mbetet në zonën urbane, vjedhjet, drejtimet e paligjshme të mjeteve dhe kalimet e paligjshme të kufirit janë përcaktuese në rapportet krahasuese

- dukuri e vecantë mbetet “importimi i subjekteve”, pra tendenca e afritimit të kontigjentit kriminal nga jashtë territorit ku kemi kompetencën tokësore, për shkak të turizmit dhe kufirit
- mbetet shqetësues kategoria e përdoruesve të narkotikëve që kthehen lehtësisht në subjekte të veprave penale ndaj personit (në familje), pasurisë dhe kuptohet dhe në fushën e narkotikëve
- subjektet e mitur kanë nisur të trajtohen nga ana jonë evidentohet rritje
- niveli i lartë i papunësisë dhe faktorët ekonomikë janë burim i rëndësishëm i një kategorie të gjerë subjektesh
- stina e verës krijon vepra dhe subjekte në një ngarkesë tej normales, pavarësisht se në këtë vit ka patur një afrim më të ulët për shkak të pandemisë

TREGUESIT E SUBJEKTEVE 2019



TREGUESIT E SUBJEKTEVE 2020



Gjatë vitit 2020:


- është proceduar me masa sigurimi mbi bazën e arrestimeve në flagrance dhe urdhërave të ndalimit të prokurorit

- ❖ është proceduar dhe me kërkesa direkte për masë sigurimi
- ❖ nuk ka patur rast për urdhërimin e lirimit të menjëherëshëm
- ❖ arrestimet në flagrancë janë kryer më tepër për disa vepra penale: Nenet 130/a, 134, 283 e 291 të K.Penal

Vlerësimet nga gjykata janë pozitive dhe pothuaj në masën më të madhe qëndrimet tona janë vlerësuar të ligjshme, masat e sigurimit janë pranuar kryesisht nga gjykata, kjo dhe për faktin se kemi vlerësuar me kujdes rastet dhe nevojat e sigurimit.

Tendencë e dukshme ka qenë ndërhyrja e prokurorit që në momentet e para, ndaj dhe janë shprehur shumë vlerësime që mund të sillnin pasoja jopozitive në ecurinë e hetimit dhe gjykimit.


ARRESTIMET, NDALIMET DHE MASAT E SIGURIMIT 2020-2019



Në dënimet gjatë vitit 2020:

- ka patur një shpërndarje të gjerë, përfshi ato alternative, përkrahur në masë nga gjykata, vlerësuar dhe rast pas rasti për arritjen e qëllimit të dënitit
- janë kërkuar dënlime ndryshme përfshi të rënda, ka patur dhe rast dënnimi maksimal
- janë aplikuar masa dënnimi me gjobë të përshtatshme, mbetet problem shlyerja e tyre
- ndryshimet e reja kanë ndikuar në luhatje të politikës së dënitit.

PASQYRË MBI DËNIMET DHE LLOJET E GJYKIMIT



Në zgjidhjet përfundimtare të çështjeve kanë ndikuar:

- ❖ ulja e afatit procedurail për mosfillimet
- ❖ qëndrimi i përgjithshëm për vlerësimin më serioz të çështjeve
- ❖ rritja e pavarësisë së prokurorëve
- ❖ referimi i materialeve pa vlera juridike penale
- ❖ kallzimet formale pa interes të shtetasve dhe institucioneve
- ❖ niveli i kallzimeve dhe referimeve
- ❖ ndryshimet proceduriale dhe ato të tjera ligjore e praktike

Numri më i madh i çështjeve të pushuara është “për mungesë fakti” ku përfshihen si rastet kur është konstatuar se fakti nuk ekziston ashtu edhe ato kur fakti nuk përbën vepër penale. Pikërisht duke analizuar procedimet e pushuara për mungesë të faktit dhe të elementeve të veprës penale, konstatohet se ka qenë shumë i nevojshëm një proces verifikimi paraprak dhe një vlerësim më i drejtë i fakteve të paraqitura në materialin kallëzues, sepse vetëm në këtë mënyrë mund të evitohet rregjistrimi i procedimeve pa pasur bazën e mjaftueshme ligjore, do të respektohen liritë dhe të drejtat e shtetasve, por gradualisht mund të ulet dhe tendenca e kallzime që nuk lidhen me natyrën penale të fakteve. Çështjet e pushuara për mungesë të provave zënë një vend më të vogël çka tregon për përpjekjet e bëra për të provuar akuzat në ngarkim të personave ndaj të cilëve ushtrohet ndjekje penale, ndërsa ka dhe çështje të pushuara “për shkaqe të tjera procedurale” ku vendin kryesor e zënë ato që kanë të bëjnë me heqjen dorë nga ankimi prej të démtuarve për ato procedime ku ndjekja penale është e kushtëzuar nga vullneti i tij. Ndërkohë tregues krejtësisht formal mbeten pushimet për shkak të parashkrimit.

Në vitin 2020 janë *ankimuar* në Gjykatë vendime pushimi dhe mosfillimi të procedimit penal, nga të cilat për rastet konkrete kanë rinisur hetimet, por gjithsesi janë në rritje. Në këtë moment kostatojmë se shpesh Gjykata e Shkallës së Parë ka qenë afër qëndrimeve tonë, por në mjaft raste kthimi ka qenë më afër formalitetit, ndërsa Gjykata e Apelit në përgjithësi shkon drejt konfirmimit të qëndrimeve të Gjykatës së Shkallës së Parë. Mendojmë se shpesh ka vend që gjykata të fokusohet më tepër në gjasat e rezultatit të mundshëm të hetimit sesa në formalizmin apo konformizimin me palët, gjithnjë në funksion të ligjit dhe drejtësisë. Nga ana jonë mbetet që të thellohen më tej vlerësimet për këto raste dhe të ulet më tej numri i rasteve ku gjykata mban qëndrim të ndryshëm. Apelimet janë në rënie nisur nga procedurat e reja, ndërsa apele kundërshtues nuk ka patur. Duhet bërë më tepër për çështjet kryesishët dhe ka shumë nevojë për përmirësim, ndërsa ndryshimet e reja ligjore krijojnë më tepër hapësirë për prokurorët që të vlerësojnë faktet për të cilat vijnë në dijeni në mënyra të ndryshme.

Gjatë vitit 2020 përsëri janë *pezulluar* një numër i madh procedimesh penale, por mbetet shqetësuese problematika e vjedhjeve. Ato zënë përsëri vendin kryesor, ndërsa ka një situatë normale për vepra të tjera, përfshi dhe ato të rënda penale. Vendimet e pezullimit janë marrë pasi janë kryer të gjitha veprimet e mundshme hetimore duke i kushtuar rëndësi të


veçantë kryerjes së veprimeve në vendin e ngjarjes, fiksimit të provave në formën e parashikuar në ligj, etj. Për këtë qëllim ka patur komunikim të përhershëm me Oficerët e Seksioneve dhe Shërbimeve të Policisë Gjyqësore, si dhe drejtuesit e tyre për përmirësimin cilësor të kryerjes së veprimeve hetimore në fazën e hetimit paraprak. Rezultate ka, por mbetet ende punë për të bërë. Numri i procedimeve penale të pezulluara mbetet ende i lartë, duhet pranuar se ka ende *mungesë profesionalizmi* nga oficerët të policisë gjyqësore të caktuar dhe se nuk ka një evidentim të qartë të kontigjentit kriminal. Ky fakt bën që shpeshherë të gjendemi të papërgatitur për të orientuar hetimin në ngjarjet kriminale dhe të mos arrijmë të identifikojmë autorët. Kjo kërkon medoemos një koordinim më të mirë të punës midis strukturave të policisë, por edhe ndërmjet Prokurorëve dhe Oficerëve të Policisë Gjyqësore. Mbetet shqetësues dhe *lëvizja apo mangësitë në personelin e shërbimeve të policisë gjyqësore*. Në këtë kontekst është e nevojshme dhe rritja e rolit drejtues e kontrollues të prokurorit në hetimin paraprak, për më tepër në fryshtë e ndryshimeve të reja ligjore, duke parë në vazhdimësi ligjshmërine e kryerjes së veprimeve hetimore nga ana e tyre dhe vlerësimin korrekt të veprimtarisë së tyre. Nga puna e mirë do të kemi më tepër rifillime të hetimeve me sukses së procedimeve të mëparshme, të pezulluara për mosbulim autorit.

Në vitin 2020 janë *dërguar për gjykim* një numër i madh procedimesh penale, duke zënë një pjesë të konsiderueshme në totalin e procedimeve penale. Treguesit e çështjeve të dërguara në gjyq janë në parametra tepër pozitivë duke ju përbajtur gjithmonë parimit për të dërguar në gjyq ato procedime për të cilat ka pasur një bazë të mjaftueshme të dhënat hetimore paraprake për provueshmërinë e akuzës në ngarkim të personave të pandehur, përmë tepër ka një garanci më shumë që është gjykata. Për *veprat penale të renda si: krimet kundër personit, pasurisë, por edhe për vepra të tjera të përhapura në territor hetimet ndaj autorëve të dërguar për gjykim janë ndjekur në gjendje arresti.*

Gjatë vitit 2020 janë *hetuar e gjykuar me sukses* procedime për vepra të ndryshme penale. Nga procedimet e dërguara për gjykim pjesën kryesore e zënë procedimet e regjistruara mbi bazën e materialeve të referuara nga organet e Policisë së Shtetit, pastaj ato nga qytetarët dhe institucionet. Ka një vlerësim pozitiv të fakteve dhe kryesisht ka një qëndrim që ka gjetur përkrahjen në vendimet gjyqësore, por dhe në fazën e ankimeve.


Në vitin 2020 kanë vazhduar të aplikohen me sukses gjykimet sipas Kodit të ndryshuar të Procedurës Penale, me efekte të dukshme pozitive. Ka një përshtatje të mirë të prokuroëve dhe hapat duken të suksesshëm në kërkesat dhe gjykimet e reja. Mbeten gjithashtu problematika të gjera në trajtimin dhe vlerësimin e situatave të reja proceduriale, në kërkesat, gjykimet, fazën e ekzekutimeve etj.

VITI 2019



■ Kerkesa per dergim ne gjyq ■ Miratim urdheri penal ■ Gjykim me marreveshje ■ Kerkesa per pushim

VITI 2020



■ Kerkesa per dergim ne gjyq ■ Miratim urdheri penal ■ Gjykim me marreveshje ■ Kerkesa per pushim

Ngarkesa tej asaj të punës normale të prokurorit në procesin e punës (kërkesat, njoftimet, etj) ndikojnë shumë në shpejtësinë dhe kohën e veprimit. Njoftimet janë problemi i ri i kërkesave në gjykatë dhe gjykimeve, situata sjell zvarritje dhe shpesh mosarritjen e qëllimit efektiv, mbetet të shihet ecuria në kohë. Ky territor përballet dhe me largime, lëvizje apo banime të shumta në shtetin grek duke ndikuar praktikisht në masë të madhe në gjetjen dhe njoftimin e personave.

Në *apelimet* rastet më të shumta janë ato nga të pandehurit, ku pothuaj në shumicën e rasteve paraqitet ankimi. Prokuroria e Apelit na ka mbështetur vazhdimisht dhe kemi një komunikim shumë të efektshëm, me rezultate shumë pozitive. Në çdo kohë ka patur korrektesë, gatishmëri të dyanshme dhe efekt pozitiv në kohë e cilësi.

Në vitin 2020 është vendosur *mosfillimi* për shumë raste të kallzuara apo referuara ku është treguar kujdesi i duhur që vendimi të merret pasi të jenë kryer verifikimet e nevojshme dhe brenda afatit të përcaktuar në ndryshimet ligjore proceduriale. Mendojmë se politika e ndjekur në rastet e vendimeve të mosfillimit ka shërbyer jo vetëm për të mos harxhuar energji të panevojshme, por edhe për të parandaluar fillimin e ndjekjes penale ndaj personave të cilët në fakt nuk dyshohen të kenë kryer ndonjë vepër penale.

Në zbatim të detyrimeve të ligjit procedural penal të gjithë personave të interesuar u janë komunikuar vendimet e mosfillimit duke u dhënë atyre mundësinë për të ushtruar të drejtën e ankimit në Gjykatë. Jemi kujdesur madje dhe të rishohim dosjet në arshivë për të realizuar me eficencë njoftimin dhe vënien në dispozicion të akteve personave të interesuar. Niveli i njohjes juridike dhe interesit subjektiv ndikojnë negativisht në ankimin e shumë vendimeve po ashtu shpesh dhe qëndrimi oportunist i gjykatës.

Mbetet tepër shqetësuese krijimi i një praktike, tashmë evidente, nga shërbimet e policisë gjyqësore, ku për shkak të pretendimeve të qytetarëve, në kushtet kur mosdokumentimi mund të krijojë idenë e moskryerjes së detyrës, thuajse detyrohet dokumentimi i një sërë *faktesh që nuk kanë lidhje me ato me natyrë penale*. Shpresojmë se gradualisht ndryshimet e reja ligjore të japid një zgjidhje përkëtë problem, i cili krijon jo vetëm ngarkesë fiktive, por pengon ushtrimin e funksioneve në kohë të arsyeshme dhe me efektivitet të prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore.

-VII-

Prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore kanë përballuar një numër të konsiderueshëm rastesh, duke nisur që nga referimet nga policia gjyqësore, kallzimet dhe ankimet nga shtetasit, procedime apo kallzime të ardhura përk kompetencë, përfaqësime në gjykimet me palë të dëmtuara, përfaqësime në gjykime me objekt në fushën e ekzekutimeve të vendimeve penale apo marrdhëniet me autoritetet e huaja, veçojmë këtu dhe marrdhëniet tepër korakte e bashkëpunuese, në kohë maksimale me sektorët përkatës në Prokurorinë e Përgjithshme.

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë gjatë kësaj periudhe kohore ka kryer edhe detyrimet procedurale në fushën e *ekzekutimit të vendimeve penale*. Gjatë vitit 2019 është urdhëruar ekzekutimi i shumë vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Ekzekutimi i vendimeve penale është orientuar sipas udhëzimeve nga Prokuroria e Përgjithshme, secili prokuror ndjek proceduren konkrete. Ka patur një ecuri korakte dhe brenda afateve të arsyeshme ligjore përk ekzekutimin e vendimeve penale, ku nuk janë evidentuar probleme. Janë ndjekur rregullisht në gjykatë edhe ankimet e të dënuarve gjatë fazës së ekzekutimeve. Problem mbetet ende ekzekutimi i dënimive me gjobë, por në ndonjë rast edhe përmoskryerje të të gjithë përpjekjeve nga organet përmbarimore, ndërsa përfitimet e përhershme nga amnistia po e kthejnë këtë lloj dënimini pothuaj të paarritshëm shpesh në ekzekutim përfundimtar. Aplikimi i veprimit të sejcilit prokuror përk ekzekutimin krijon disi probleme në mënyrën e funksionimit dhe rakordimit.

Marrëdhëniet juridikSIONALE me jashtë janë realizuar më eficencë si dhe më lart kemi përmendur ku gjatë vitit 2020 janë përfunduar procedurat e ekstradimit përk jashtë shtetit për të dënuar, rastet e njohjes së vendimeve penale të huaja, shpalljet në kërkim ndërkombëtar, por dhe njoftime të personave. Mbetet problem rakordimi në nivel kombëtar.

TREGUESIT KRYESORË TË PUNËS PËR VITIN 2020

Procedimet penale dhe materialet referuese që janë hetuar nga secili prej prokurorëve gjatë vitit 2020, krahasuar dhe me një vit më parë janë si më poshtë.:

VITI 2019

Prokurori	Çështje	Dërguar në gjykatë	Pushuar	Pezulluar	Shpallur moskompetencia
Lorenc Mërkuri	620	74	11	7	4
Sali Hasa	515	119	73	114	16
Elidon Hysenaj	113	16	8	15	2
Ilir Hoxha	468	114	37	117	2

VITI 2020

Prokurori	Çështje	Dërguar në gjykatë	Pushuar	Pezulluar	Shpallur moskompetencia	Mosfillime
Lorenc Mërkuri	363	21	13	144	4	54
Sali Hasa	409	67	56	73	7	129
Elidon Hysenaj	245	58	17	57	2	118
Ilir Hoxha	361	63	62	78	9	119
Alba Dhima	124	28	14	15	12	86
Aurora Hajro	156	31	20	20	17	77

-VIII-

Drejtuesi i Prokurorisë është përpjekur të përmirësojë organizimin e brendshëm të punës dhe disiplinën e punës në Prokurori me qëllim rritjen e kontrollit ndaj punës së prokurorëve për procedimet penale që ata kanë në hetim dhe gjykim, por edhe duke marrë pjesë vetë aktivisht dhe duke ndihmuar në zgjidhjen konkrete të tyre. Drejtuesi ka trajtuar një numër të konsiderueshëm çështjesh që lidhen me vepra të ndryshme penale, në pozicionin e prokurorit, por dhe më pas në funksionin e ri. Në këtë kuadër i ka kushtuar një kujdes të veçantë trajtimit të të gjitha materialeve kallëzuese, regjistrimit të procedimeve penale, shpërndarjes së një ngarkese uniforme për të gjithë prokurorët, për sa ka qenë e mundur, kontrollit gjatë fazës së hetimeve, kontrollit të çështjeve në momentin e përfundimit të tyre duke u kujdesur që vendimet e marra të janë në përputhje me ligjin dhe për çështjet e dërguara në gjyq të zbatohet një politikë penale sa më e unifikuar duke vlerësuar rrezikshmérinë e veprave penale dhe të autorëve, por edhe përhapjen e tyre në territorin ku Prokuroria pranë

Gjykatës së Shkallësë së Parë me JuridikSION të Përgjithshëm Sarandë ushtron funksionet e saj.

Zëvendësimi i prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore është bërë vetëm në rastet e largimit të prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore për shkaqe ligjore, në interes të ushtrimit të detyrave ligjore.

Në gjykimet është orientuar një praktikë institucionale, janë diskutuar vazhdimisht problemet konkrete dhe ecuria, ndërsa ka një bashkëpunim ligjor dhe raport në kohë shumë profesional dhe efikas me Prokurorinë e Apelit Gjirokastër. Janë të rralla rastet kur nuk kemi patur të njëjtin mendim, por gjithnjë vetëm në situata tepër të diskutueshme juridike dhe duke patur në konsideratë dhe sjelljen në kohë të gjykatave. Gjithsesi, pavarësisht pretendimeve që mund të kemi për bazueshmërinë e vendimeve të gjykatës, duhet të merret në konsideratë në vazhdimësi qëndrimi i tyre për të bërë kujdes në sigurimin dhe dokumentimin ligjor të provave në hetimin paraprak, por edhe përritjen e rolit të prokurorit gjatë shqyrtimit gjyqësor, sidomos në fazën e administrimit të provave. Për fazën e gjykimit i është kushtuar rëndësi sigurimit të provave të mjaftueshme për të vërtetuar fajësinë e të pandehurve si dhe diferencimit të llojit dhe masës së dënimit në varësi të veprës penale të kryer.

Për veprat penale me rrezikshmëri të theksuar shoqërore, si ato kundër jetës dhe shëndetit, vjedhjet, mashtrimet, shkeljet e rregullave të qarkullimit rrugor, veprat penale në fushën e narkotikëve, etj. kërkesat tona për llojin dhe masën e dënimit kanë qenë të tilla që t'i shërbjnë parandalimit dhe ndëshkimit të këtyre veprave penale, por duke analizuar gjithë treguesit e këtij viti mendojmë se është gjithnjë e nevojshme që *politika e dënimit*, të jetë fleksibël me përparësitë ligjore dhe rekomandimet, duke u përmirësuar në vijimësi dhe duke u përshtatur me format dhe tendencat e kriminalitetit në territor dhe në raport me tendencat kombëtare.

Numri i apeleve (nuk ka patur apele kundërshtuese) ka qenë në nivele më të larta për shkaqe, mendoj të bazuara dhe në raport me sjelljen e gjykatës ku kanë ndikuar dhe llojet e reja të gjykimit. Kjo ka patur dhe një ndikim pozitiv mbasi nuk kanë krijuar ngarkesa fiktive dhe ndikime në veprimtarinë gjyqësore, ndërsa në vazhdimësi politika e dënimit deri në formën e prerë ka qenë arsyeshëm pranë kërkimeve tona.

Gjatë vitit 2020 vijoi kryerja e detyrave në përputhje me ligjin dhe udhëzimet përkatëse. Konstatohet se me gjithë problemet që janë hasur ka tendencia pozitive në përmirësimin e punës. Ka ardhur në përmirësim dhe kryerja e hetimeve paraprake nga oficerët e Shërbimeve të Policisë Gjyqësore, falë edhe kontakteve më të ngushta që janë vendosur mes tyre, prokurorëve dhe drejtuesit të prokurorisë. Është fakt që një numër i madh veprash penale janë hetuar nga oficerët e këtyre shërbimeve.

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallësë së Parë Sarandë është në nivele shumë të mira bashkëpunimi me shërbimet dhe drejtuesit, rrjedhojë e interesit të detyrës tonë të përbashkët për rezultate të arritura dhe ato që pretendojmë të arrijmë në të ardhmen.

Gjatë vitit 2020 nuk ka pasur raste që ndaj prokurorëve apo oficerëve të policisë gjyqësore të janë marrë masa disiplinore. Pavarësisht kësaj, duke trajtuar me shumë seriozitet shqetësimet e ngritura nga palët në proçes apo qytetarët, është kërkuar në vazhdimësi që

prokurorët të jenë korrekt me qytetarët, me vartësit, me kolegët, të ruajnë një figurë të pastër etiko-morale duke i shërbyer në radhë të parë vetes, por edhe ruajtjes së një imazhi të pastër të Institucionit. Këtij qëllimi i ka shërbyer edhe transparenca e reflektuar me qytetarët, por edhe me median kur këto të fundit kanë shfaqur interes për çështje konkrete të veprimtarisë së organit. Organizmi dhe mbledhja e prokurorëve janë zhvilluar me seriozitet, me gjithë trupën e prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore me tematikë të përcaktuar duke trajtuar problemet që kemi hasur në praktikën e përditshme. Janë diskutuar dhe kanë nisur të aplikohen ndryshimet e reja ligjore dhe po ecet mirë në azhornimet përkatëse ligjore, teknike dhe administrative.

Administrata ka punuar me seriozitet dhe puna e këtyre punonjësve ka qenë mbështetje e rëndësishme për prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore në ushtrim të detyrës së tyre, por edhe për qytetarët të cilëve u janë ofruar shërbime administrative të cilësisë së lartë, evidente kjo dhe në normalitetin e veprimtarisë sidomos në periudhat me ngarkesë të lartë pune dhe veprimtarie institucionale. Megjithë situatën e pandemisë shërbimet nuk janë ndalur apo janë kufizuar shumë pak, imponuar nga situata.

Drejtimet e përgjithshme janë në nivele të kënaqshme dhe në veprimtarinë financiare. Realizimet janë brenda limitit dhe aktiviteti është kushtëzuar nga mundësita dhe nevojat emergjente. Është realizuar kontraktimi për ruajtjen e objektit dhe veprime të tjera në përputhje me ligjin. Komunikimet me zyrën përkatëse në Prokurorinë e Përgjithshme janë të përhershme dhe janë një ndihmë e madhe në veprimtarinë tonë. Kemi shlyer në maksimum detyrimet dhe nuk ka probleme me pagesat e subjekteve që janë afruar në interes të procedimeve penale. Shuma e shpenzimeve është 2.155.575 Lek, ku për avokatët jane paguar 219.000 Lek, akte ekspertimi autoteknikë/topografike/etc. 1.451.300 Lek, per ASHK-në 260.600 Lek dhe për psikologët e përkthyesit 224.675 Lek.

-IX-

Nga analiza në tërësi e elementëve që u përmendën më lart, evidentojmë këto problematika duke propozuar marrjen në konsideratë për efektivitetin e punës dhe ushtrimit të funksionit:

- ngarkesa reale dhe ndryshimet ligjore kanë nevojë për zgjerim të administratës, konkretisht rritjen e tyre dhe afrimin e kancelarit (sipas strukturës së re ligjore)
- mbajtja në konsideratë e ngarkesës gjatë sezonit turistik, etj., mundësishët duke sjellë prokurorë apo oficerë të komanduar, krijimi i një mekanizmi eficent për moskompetencat.
- nevojitet në vazhdimësi një mekanizëm për referimet pa vlerë juridike penale dhe njoftimet që nuk lidhen me fakte penale; orientime konkrete dhe të thjeshta lidhur me problematikat e zbatimit të legjisacionit të ri
- të bëhen përpjekje që të ndahet puna e prokurorit nga impenjimet që nuk lidhen me funksionin e tij (statistika, akses dhe plotësime në sistem etj.); të realizohet për çdo prokuror aksesi në sistemet kombëtare të të dhënave; të ndërmerrin masa për rritjen e sigurisë në institucione dhe përmirësimin e kushteve, bazës dhe nivelit teknik

- të destinohen kërkesat për informacion brenda strukturës statistikore që disponojmë dhe të shihet mundësia për krijimin e sitemit të ri apo plotësimin e tij me treguesit e rinj sipas ndryshimeve ligjore që janë bërë.

Ndër priorititet tona kryesore për të ardhmen kemi përcaktuar:

- ndjekja me përparësi e procedimeve penale për veprat penale në tregues jo të mirë; rritja e hetimeve kryesisht dhe proaktive; rritja e përpjekjeve për zbulueshmërinë, përmirësimi i treguesve gjyqësorë, cilësimi ligjor dhe politikës penale
- ndjekja në vazhdimësi e çështjeve për ngjarje kriminale të rënda të pezulluara në vitet e mëparshme, në bashkëpunim të ngushtë me shërbimet; ndjekja me përparësi e rasteve që kanë ngadalësi apo efekt të rëndësishëm në funksionin dhe imazhin e institucionit, përfshi dosjet e mbartura dhe të pezulluara, si dhe përpjekje maksimale për përfundimin në një kohë sa më të shpejtë të tyre
- krijimi i të gjitha kushteve për ecurinë normale të ushtrimit të funksionit duke qenë në raport të drejtë dhe të përhershëm me proceset ligjore në zhvillim, urdhërat dhe udhëzimet e Prokurorit të Përgjithshëm, si dhe veprimtarinë e institucioneve të tjera
- rritja e bashkëpunimit me institucionet; rritja e funksionit drejtues dhe kontrollues të prokurorit në hetimet paraprake mbi shërbimet e policisë gjyqësore; përmirësimi i organizimit, drejtimi dhe kontrolli brenda organit të prokurorisë për t'ju përgjigjur në kohë dhe me cilësi kërkesave të luftës kundër kriminalitetit
- respektimi i detyrimeve të ligjit procedural penal; rritja e profesionalizmit të prokurorëve dhe ruajtja e një figure morale të pastër jashtë çdo ndikimi

DREJTUESI I PROKURORISË

LORENC MËRKURI

Sarandë, data 28.02.2021

